



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 5 qershor 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet që vijojnë:

U miratuan procesverbalet e mbledhjeve të Bordit nr. 21, datë 06.05.2026, nr. 22, datë 13.05.2026, nr. 23, datë 21.05.2026 dhe nr. 24, datë 28.05.2026.

U vendos fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “GREENSOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

U vendos fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ASSA ENERGY SOLUTIONS” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

U vendos fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “NEXORA” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.

U zgjat vendimmarrja e Bordit lidhur me kërkesën e shoqërisë “DRINI BULQIZË” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së prodhimit të energjisë elektrike tek shoqëria “HEC POLEMI” sh.p.k.

U miratuan disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 68, datë 08.04.2025 “Mbi licencimin e shoqërisë “RENEW” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 MW”, i ndryshuar.

U miratua shfuqizimi i vendimit nr. 199, datë 15.08.2025 “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “RENEW” sh.p.k. si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “ProCredit Bank” sh.a.”.

U miratua kërkesa e shoqërisë “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të saj si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a.

U miratuan disa ndryshime në treguesit e kritereve standarde të cilësisë së shërbimit në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

Në kuadër të çështjeve të tjera, u trajtua informacioni mbi procedurën për shqyrtimin e Planit 5-vjeçar të Zhvillimit të Rrjetit të Shpërndarjes për periudhën 2023–2027.

Vendimet e plota publikohen në faqen zyrtare të ERE-s dhe në Fletoren Zyrtare.